



Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!

Rrethanat dhe mjedisi ndikojnë mbi ne, por ne jemi përgjegjës për vetveten.

Paulo Coelho

*Në këtë buletin do të gjeni:*

**Memorandumi i bashkëpunimit për “Zbatimin e Programit të IPARD III 2020-2027**

**Inventarizimi dhe prioritizimi i PCB-ve**

**Takimi i rrjetit të NFP Europiane në EEA**

Faqe 1

**Aplikimet për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**

**Trajnim mbi procesin e harmonizimit të ligjit në Shqipëri**

Faqe 3

**Plotësimi dhe raportimi online i Regjistrit të Shkarkimeve dhe të Transferimit të Ndotësve**

**Dita e EIONET**

Faqe 2

**Takimi i Bordit drejtues të rrjetit IMPEL**

**Aktivitetet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në sektorin e kimikateve**

Faqe 4

**AKM në panelin TIRANA CITY TALKS**

Faqe 5

## Memorandumi i bashkëpunimit për “Zbatimin e Programit të IPARD III 2020-2027”

Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit Znj. Arta Dollani së bashku me Drejtoreshën e Përgjithshme të Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural Znj. Eranda Selmanaj, nënshkruan në 20 Janar memorandumin e bashkëpunimit për “Zbatimin e Programit të IPARD III 2020-2027” midis AZHBR dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit .



Qëllimi i këtij bashkëpunimi është çertifikimi i standardeve mjedisore për investimet që do të realizohen dhe financohen në kuadër të këtij programi. Investimet duhet të kryhen duke respektuar dhe përmbushur standardet e përcaktuara dhe duke mos i cënuar ato.

## Inventarizimi dhe prioritizimi i PCB-ve dhe përgatitja e vlerësimeve tematike të vendit për Diagnostifikimin Kombëtar Ndërkufitar në Shqipëri.

Në datë 7 Shkurt u mbajt takimi Kombëtar i Palëve të Interesit për Analizën Diagnostike Ndërkufitare (TDA) në kuadër të projektit "Inventarizimi dhe prioritizimi i PCB-ve dhe përgatitja e vlerësimeve tematike të vendit për Diagnostifikimin Kombëtar Ndërkufitar" që **Agjencia Kombëtare e Mjedisit** po zbaton në bashkëpunim me UNEP bazuar në ekzekutimin e Programit Global Environmental Facility për Detin Mesdhe (Programi GEF Med) gjatë periudhës 2020-2025.



## Ky takim u përqëndrua më shumë në:

1. Reduktimi i ndotjes nga kimikatet dhe mbetjet e dëmshme në pikat e nxehta mesdhetare
2. Matja e Progresit ndaj Ndikimeve.

Në takim morën pjesë përfaqësues nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti i Shkencave të Natyrës, Koorporata Energjitike Shqipëtare (KESH), ekspertë mjedisi të fushave të ndryshme, ekspertë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe eksperti ndërkombëtar të ardhur nga MEDPOL.



## Takimi i rrjetit të NFP Europiane në EEA

**Agjencia Kombëtare e Mjedisit** si përfaqësuese e Shqipërisë në Agjencinë Europiane të Mjedisit dhe Rrjetin European të Informacionit dhe Vëzhgimit Mjedisor, ka vijuar përmbushjen e sfidave të saj të lidhura me këtë angazhim.

Rrjeti kombëtar i eksperteve tematikë pjesë e EIONET/ EEA totalisht të përfshirë në aktivitetet e EEA të cilat në fillim të këtij viti morën miratimin e Komisionit European për vazhdimësi të mbështetjes dhe asistencës në funksion të rritjes dhe forcimit të metejshëm të kapaciteteve teknike dhe njerëzore të vendit në rrugën e anëtarësimit, jo vetëm në BE por edhe EEA, të dyja këto procese të pandara.



Kështu u miratua Programi i Punës së EEA me vendet e Ballkanit Perëndimor për periudhën 2023- 2025 e fokusuar kryesisht tek tematikat që kanë të bëjnë me Cilësinë e Ajrit, Ujërat, Tokat, Biodiversitetin, Digitalizimi etj.

Shumë punë dhe sfida të përbashkëta që na bashkojnë e që ende kemi përpara si pjesë e Rrjetit European të Informacionit dhe Vëzhgimit Mjedisor/ EIONET e që kërkojnë angazhim

maksimal të të gjithë ekspertëve dhe institucioneve kombëtare.

Në këtë frymë u zhvillua edhe takimi i radhës i rrjetit të NFP European në EEA ku mori pjesë edhe **Agjencia Kombëtare e Mjedisit** në 29 Shkurt 2023.



#### • Qëllimi kryesor i këtij trajnimit:

1. Të ndihmojë operatorët për të kryer detyrimet e raportimit të PRTR sipas legjislacionit kombëtar,
2. T'u demonstrojë operatorëve përdorimin e softuerit të raportimit dhe hapat e procedurës së raportimit
3. Të identifikojë vështirësitë dhe t'i adresojë ato,
4. të ofrojë asistencë dhe shembuj për metodat e raportimit për matjen, llogaritjen ose vlerësimin e emetimeve dhe çlirimeve,
5. Të vlerësojë dhe të kontrollojë cilësinë për sektorin e industrisë së çimentos,
6. të identifikojë dhe diskutojë zgjidhjen e vështirësive aktuale të procesit praktik të raportimit sipas objekteve
7. Të arrijë progres në tejkalimin e vështirësive dhe përmirësimin e cilësisë së raportimit.

#### Dita e EIONET

Data 1 Mars 2023 ishte një event european i kushtuar për EIONET në rrugëtimin dhe arrijtet e tij që nga krijimi e deri më sot.

Edhe në këtë aktivitet shumë dimensional, **Agjencia Kombëtare e Mjedisit** përfaqësoi Shqipërinë dhe ishte ndër të përzgjedhurit për të ekspozuar në një mini standë, rrjetin e saj të 'EIONET Albania' me gjithë dimensionin e funksionet e saj.



Aktiviteti pati një vëmendje dhe mbulim maksimal nga mediat daneze dhe ato europiane dhe të ftuarit ishin nga gjithë institucionet mjedisore të vendeve të BE dhe të KE. Ekspertet kombëtare shqiptare vijnë të punojnë fort në përbushjen e detyrimeve raportuese të tyre drejt EEA edhe pas ndryshimeve revolucionarizuese të jashtezakonshme të infrastrukturës së EEA.

#### Trajnimi operatorëve industrial mbi mënyrën e plotësimit dhe raportimit online të Regjistrisë të Shkarkimeve dhe të Transferimit të Ndotësve

Qendra Burimore e Mjedisit (REC Albania) në bashkëpunim me **Agjencinë Kombëtare të Mjedisit** organizuan në datat 12-13 Prill takimin me temë :

#### “Rritja e raportimit të Rregjistrave të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve për reduktimin e emetimeve”

##### • Ky trajnim u bazua në:

1. Rritja e kapaciteteve të operatorëve dhe shkëmbimi i përvojës në raportimin e RSHTN-së”, në kuadër të zbatimit të projektit “Rritja e RSHTN-ve për qëndrueshmëri;
2. Përbushja e detyrimeve të regjistrisë European të RSHTN (E-PRTR, Direktivës së emetimeve industriale (IED)
3. Protokollin të Regjistrisë të Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve (PRTR)”që po zbatohet nga “Participatio Environmental Policy Advisory Limited Liability Company (Participatio Ltd.), Hungari.



## Aplikimet për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Për periudhen Janar-Prill 2023, janë marrë në shqyrtim dhe janë dhënë vendime për 389 projekte, që i nënshtrohen procedurës së Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis.

Pjesën më të madhe të aplikimeve e zënë projektet infrastrukturore private dhe te enteve publike.

- Ndër projektet publike mund të përmendim:
  - Ndërtime godinash banimi/shërbimi.
  - Ndërtime ujësjella, rrugë,
- Ndër projektet private përmendim:
  - Impiante Fotovoltaike/ Eolike/ HEC.
  - Projektet në fushën e turizmit dhe agroturizmit.
  - Projekte infrastrukturore industriale.

E gjithë procedura është ndjekur në zbatim të:

- Ligjit 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar
- Ligjit Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”

Një rol të rëndësishëm në këtë proces ka edhe procedura e konsultimit me publikun në vendimarrjen mjedisore, e cila kryhet për projektet në fushën e energjitikës dhe për procesin e thelluar të VNM-së, në bazë të VKM 247/2014.

Konsultimi me publikun kryhet për të garantuar një proces të hapur vendimmarrjeje, gjatë vlerësimin të ndikimeve negative në mjedis si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Gjithashtu siguron një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, përpara miratimit të projekteve për zhvillim;

## Trajnim mbi procesin e harmonizimit të ligjit në Shqipëri

Në datat 6-7 Mars, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me mbështetjen e programit SANE 27 - faza II, në kuadër të përgatitjes për procesin e negociatave me BE-në, organizoi trajnimin “Procesi i harmonizimit të ligjit në Shqipëri - metodologji për transpozimin e acquis të BE-së për Kapitullin 27 mjedisi dhe ndryshimet klimatike” në Tiranë.



Në trajnim morën pjesë edhe përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Qëllimi i trajnimit ishte të përmirësonte njohuritë dhe të kuptuarit e administratës shqiptare në lidhje me transpozimin e acquis të BE-së për Kapitullin 27. Gjatë trajnimit u prezantuan metodat dhe teknikat e transpozimit, përvoja në Shqipëri dhe planifikimi i transpozimit të acquis të BE-së në kombëtare. Legjislacioni që merr në konsideratë procesin e shqyrtimit dhe negociatave të BE-së. Gjithashtu, u zhvilluan ushtrime praktike në mënyrë që pjesëmarrësit të praktikojnë dhe të kenë një perceptim më të mirë të transpozimit.



### Takimi i Bordit drejtues të rrjetit IMPEL

Takimi i Bordit drejtues të rrjetit IMPEL me drejtues e përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si dhe Institutit të Shëndetit Publik, ishte interaktiv dhe i frytshëm. Pjesëmarrësit ishin aktivë me prezantimet e tyre për përfshirjen e ekspertëve pjesëmarrës në projektet të cilat japin mundësi për shkëmbim eksperiencash midis vendeve anëtare, zbatimin e legjislacionit mjedisor si dhe mundësi zgjedhje për sfidat në të ardhmen.



(Programi GEF Med) gjatë periudhës 2020-2025 me objektivin kryesor “Reduktimin e ndotjes nga kimikatet dhe mbetjet e dëmshme në pikat e nxehta në Mesdhe. AKM dhe UNEP do të bashkëpunojnë për realizimin e projektit/programit të titulluar "Inventarizimi dhe prioritizimi i PCB-ve dhe përgatitja e vlerësimeve tematike të vendit për Diagnostifikimin Kombëtar Ndërkufitar - Raport Analizë" në Shqipëri. Në kuadër të këtij projekti gjatë periudhës Shtator 2022 – Mars 2023 janë organizuar disa takime .



Përfaqësuesi i AKM-së, si Pikë Fokale e Konventës së Stokholmit ka marrë pjesë në dy takime online në kuadër të projektit GEF 10924 në Shqipëri, më 27 shkurt 2023 dhe më 9 mars 2023. Gjithashtu më 6 shkurt 2023, i është dërguar sekretariatit të Konventës së Stokholmit, formati i Aneksit F me të dhënat në lidhje me kimikatet: chlorpyrifos, PFOA dhe PFHxS.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit gjatë periudhës Janar –Prill 2023 ka shqyrtuar dosje të subjekteve të ndryshme në kuader të Komisionit të Biocideve nga Ministria e Shëndetësisë, në bazë të Ligjit për menaxhimin e kimikateve Nr. 27/2016 datë 17/3/2016 ,VKM-së Nr 95 datë 09.01.2019 si dhe VKM-së Nr.488 datë 29.06.2016, duke kontrolluar SKEDËN ME TË DHENAT E SIGURISË (MSDS), etiketën për marrjen e autorizimit për regjistrim biocidi dhe vendosje në treg.

### Aktivitetet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në sektorin e kimikateve

Në kuader të bashkëpunimit me ECHA më 9 mars 2023, përfaqësues nga Sektori i Kimikateve morën pjesë në takim online me fokus, përditësim mbi aktivitetet e ECHA, marrëveshja e re e kontributit IPA dhe aktivitetet e parashikuara në kuadër të saj dhe aktivitetet e ardhshme të organizuara nga ECHA, përditësime mbi aktivitetet shqiptare etj.

Kanë vijuar aktivitetet e planifikuara për periudhën 15 qershor 2022-15 mars 2023, me ekspertë nga KEMI, në kuadër të projektit “Përmirësimi i Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri”.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është e angazhuar me Programin “Global Environmental Facility” për Detin Mesdhe

Përfaqësuesi i AKM-së i emëruar si Pikë Fokale e Konventës së Roterdamit ka marrë pjesë në disa takime online për Procedurën PIC dhe në kuader të saj gjatë kësaj periudhe janë marrë 59 Njoftime Eksporti nga ECHA. Për të forcuar legjislacionin kombëtar të kimikateve në fuqi, për çdo njoftim të marrë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me institucionin që merr pjesë në autorizimin e kimikateve në Shqipëri, ka kryer një proces verifikimi, ka përgatitur formatet për dhënien e përgjigjeve në lidhje me procedurat e PIC, bazuar në zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 665, datë 21.9.2016, për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme.

## AKM në panelin “TIRANA CITY TALKS”

AKM ishte pjesë e panelit në TIRANA CITY TALKS - Qyteti dhe Ndryshimet Klimatike së bashku me Bashkinë Tiranë në një panel ekspertesh e përfaqësuesisht të grupeve të ndryshme të interesit. Folëm hapur dhe shumë sinqerisht në lidhje me sfidat që kemi përpara efekteve të ndryshimeve klimatike në kryeqytetin tonë dhe përballimin e tyre. Çështjet e Politikave Mjedisore, Ekonomisë së Gjelbër dhe Planifikimit urban ishin në fokus të diskutimeve të ndara në tre panele diskutimesh, që emërues të përbashkët kishin: mbrojtjen e mjedisit ku ne jetojmë, nëpërmjet zbatimit një qasje zhvillimore të Tiranës, në linjë me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe transformimit të tij në një Qytet të Gjelbër.



“Plani Vendor për Tiranën e Gjelbër” propozon një sërë masash konkrete avangarde dhe në linjë me politikat e reja të zhvillimit ekonomik, të bazuara tek përdorimi shumë i kujdesshëm dhe i qëndrueshëm i resurseve natyrore, që nën kërcenimin e efekteve të ndryshimeve klimatike thërrasin për vëmendje dhe adresim të drejte.

Vetëm së bashku mund tja dalim e përballemi me sfidat mjedisore!

## Dita Globale e Riciklimit

Në ditën Globale të Riciklimit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit zhvilloi një orë mësimore në natyrë, aty ku e gjithë vëmendja jonë duhet të jetë maksimale.

Rëndësia e kësaj dite konsiston në rritjen e ndërgjegjësimit duke promovuar ricikimin e produkteve si një mënyrë për ruajtjen, mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve natyrore.



Sëbashku me nxënësit e shkollës “New York Schools Tirana” diskutuam se si ata mund të jenë mbrojtësit e vegjël të natyrës dhe cilat janë hapat që mund të ndërmarrin për të ricikluar produktet, përfitimet e riciklimit dhe arritjen e qëndrueshmërisë mjedisore.

Përfitimet nga procesi i riciklimit:

- Reduktimi i sasisë së mbetjeve;
- Ruajtja e burimeve natyrore;
- Ruajtja e energjisë;
- Ulja e kostove që lidhen me prodhimin e produkteve të reja;
- Ulja e ndotjes;

Aktiviteti u ndërthur gjithashtu me postera dhe krijime të bëra nga nxënësit me materiale të riciklueshme si edhe kuize të ndryshme për të nxitur aftësitë e tyre për zgjidhjen e problemeve mjedisore. ♻️



## Dita Ndërkombëtare e Edukimit Mjedisor

Rëndësia e kësaj dite konsiston në identifikimin e çështjeve mjedisore dhe rritjen e ndërgjegjësimit për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit duke zbutur impaktin e shkaktuar nga ndryshimet klimatike.

Sëbashku me nxënësit e shkollës “Elite” diskutuam se si ata mund të jenë mbrojtësit e vegjël të natyrës dhe cilat janë hapat që mund të ndërmarrin për të ruajtur burimet natyrore dhe për të arritur qëndrueshmërinë mjedisore.



Ritheksuam gjithashtu domosdoshmërinë e zbatimit të parimit të 3R-ve (Reduktim, Ripërdorim, Riciklim), si dhe kompostimit si një proces sa praktik dhe efikas, të cilat janë mënyrat e duhura për të arritur qëlimin e përbashkët: “Mbro mjedisin, mbro të ardhmen! ♻️”

Aktiviteti u ndërthur gjithashtu me postera të bëra nga nxënësit dhe kuize të ndryshme për të nxitur aftësitë e tyre për zgjidhjen

e problemeve mjedisore.

